Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					



---

<b>Çmimi total me TVSH:</b>	
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> <b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

---

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

**Ne hartimin e specifikimeve teknike i jemi permbajtur rekomandimit te perbashket te Agjencise se Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit publikuar ne adresen [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) nr. 10181 prot dhe 8514 prot date 19.11.2018.**

Autoriteti kontraktor duhet te mbaje ne konsiderate qe produktet ushqimore kategorizohen ne:

Ushqime me origjine shtazore

Dhe

Ushqime me origjine joshtazore

- 1.1. Per produktet ushqimore te fresketa te fruta-perime te paperpunuar.**

---

Ne flete analizat qe do shoqerojne cdo sasi te mallit te levruar, operatori ekonomik te shenoje sasine e prodhimit qe i referohet kjo flete analize.

## **1.2. Per ushqimet dhe produktet ushqimore**

Ne vendosjen e specifikimeve teknike per kete kategori te produkteve duhet te mbahet ne konsiderate qe, per te gjithë produktet ushqimore do te zbatohen dispozitat e Legjislacionit per Ushqimin

Ndermjet te tjerave, autoriteti kontraktor duhet te percaktoje ne specifikimet teknike qe:

Operatori ekonomik duhet te paraqese raport analize origjinale ose kopje te noterizuar leshuar nga nje laborator i autorizuar i kontrollit ose i references, per produktet e ofruara.

Raport analiza perkatese duhet te jete sipas llojit te produktit, numrit te Lotit<sup>2</sup>, dhe jetegjatesise se produktit dhe te kete lidhje me produktin/mostren e ofertuar. Ne kete raport analize duhet te jete shenuar: emertimi i produktit ose nje e dhene tjeter qe tregon ose lidh kete raport analize me produktin e ofertuar.

Produkti kur te levrohet, duhet te jete i shoqeruar me certifikaten e origjines dhe flete analize per treguesit e sigurise e cilesise, sipas legjislacionit ne fuqi per ushqimin.

Te gjithë treguesit organo-leptike dhe fiziko-kimike te produktit te ofertuar/mostres qe perfaqesojne artikullin duhet te perputhen plotesisht me treguesit e shenuar ne specifikime teknike dhe te Standardit Shteteror perkates. Standardet shteterore per karakteristikat e produkteve ushqimore jane te disponueshme dhe jane te publikuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit (DPS) ne faqen e internetit *ëëë.dps.gov.al*.

Produktet ushqimore, objekt i Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 1344, date 10.10.2008 "Per miratimin e rregullave per etiketimin e produkteve ushqimore", neni 4 dhe 13, te jene te pajisura me etiketat respektive.

Frigoriferet e instaluar ne ambientet e operatorit ekonomik te kene rregjistrat perkates per monitorimin e temperatures, sipas Udhezimit te Ministrit te Bujqesise Nr. 22 date 25.11.2010 "*Per kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te higjenes per stabilimentet e ushqimit dhe operatoret e biznesit ushqimor*".

---

Automjetet e përdorur për transportin e produkteve duhet të jenë të pajisura me matës temperaturë (taograf) për gjurmimin e temperaturës gjatë levizjes të mjetit.

### 1.3. Produkt mishi/ i përpunuar mishi.

- a. Pjesa e karkases (shpatull, kofshë dhe gjoks) duhet të jetë e vëlosur me vulën e kontrollit veterinar.
- b. Çdo parti/karkase mishi duhet të shoqërohet me certifikatë veterinare, e cila garanton sigurinë e produktit "mish" dhe me të cilën vërtetohet se, nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje, por që është i sigurt dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik.

#### Specifikime Teknike:

##### 1- Buka: (buke thekre & e integruar)

Sipas kërkesave të përcaktuara në urdherin Nr.457, datë 13.06.2018, për dy institucionet (kopsht & çerdhe) do të bëhet furnizimi me dy lloj buke, buke thekre dhe buke me miell të integruar.

##### a).Treguesit teknik: (Bazuar në STASH - 1411/87)

- **Korja:** E lëmuar, pa flluska, pa çarje e pjesë të djegur dhe pa shkeputje të saj nga tulli. Me ngjyrë të njellojtë mjaltë në të kuqerremt.
- **Tulli:** Mase e njellojtë e pjekur mirë, jo e ngjyeshme me porë të shpërndara në mënyrë të njëtrajtshme dhe pa gjurmë mielli të pa brumosur. Kosinsisenca elastike me shtypje të lehtë rikthehet në gjendjen e parë, jo i thembueshem dhe pa shtresa.
- **Era dhe shija :** E këndshme e bukes së pjekur mirë. Pa erë e shije të hidhur, të thart, myku ose të huaj.
- **Forma :** E rregullt pa shtypje e deformime.
- **Lendet e huaja :** Nuk lejohen.

##### b).Treguesit fiziko – kimik:

- 
- ❖ Lageshtira ne % jo me shume se 45
  - ❖ Poroziteti ne % jo me pak se 70
  - ❖ Aciditeti ne grade jo me shume se 4.5

### **c).Transporti i bukes:**

- Do te behet me mjete të pastra, të mbrojtura nga demtimet e faktoret e tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.
- Buka dergohet per konsum jo me pare se 3 ore nga koha e pjekjes.
- Ambalazhimi: Buka ambalazhohet ne kuti plastike të lejuara per produktet ushqimore dhe duhet te jete e paketuar ne qese letre.

### **2- Qumeshti:**

- Te jete i fresket, i pasterizuar dhe i sterilizuar.
- Te mos kete ne permbajtjen e tij lende konservuese dhe neutralizuese.
- Te plotesoje treguesit organo-leptike dhe fiziko-kimike.
- Ambalazhimi te jete brenda kushteve higjieno-sanitare.
- Ruajtja dhe transportimi me temperature 2 deri ne 8 grade.
- Permbatja e yndyres deri ne 2 %.
- Ambalazhimi brenda kushteve higjieno-sanitare, dhe ne etikete te permbaje peshen neto, daten e prodhimit, daten e skadences.
- Gjate perpunimit/transportit zbatohen te gjitha rregullat higjieno-sanitare e veterinare ne fuqi.

**Nuk lejohet perdorimi i lendeve konservuese, neutralizuese dhe i lendeve te huaja ne qumesht**

### **3- Mish Viçi:**

- Mish viçi, cilesia e pare (STASH 1441\87)
- Pamja e jashtme: Mish i bute me ngjyre trendafil i çelet.
- Furnizimi i mishit do te behet pa te brendshme dhe pa koke.
- Te jete i vulosur nga sherbimi veteriner.
- Transporti i mishit do te behet me mjete të mbyllura, të pastra e të dezinfektuara, posaçerisht per mishin dhe te pajisura me frigorifer.

### **4- .Sheqer:**

- Permbajtje pluhuri te perbere nga kristale te imta, pa lende te huaja, i thate ne te prekur.
- Ngjyra e bardhe dhe me shkelqim
- Te tretet plotesisht ne uje, tretesira e tejdukshme dhe pa ngjyre
- Lageshtira 0.074
- Polarizimi 99.62
- Te jete i paketuar ne pako letre me peshe 1 kg dhe i etiketuar\

---

## 5- Makarona:

- Makarona spageti me gjatesi 25-30 cm dhe makarona supe ne forma te ndryshme.
- Te jene ne forme te rregullt dhe gjate zierjes nuk duhet te qulloren.
- Lageshtira jo me shume se 13 %
- Rritja e vellimit pas zierjes jo me pak se dy here.
- Te jene te ambalazuara ne qese polietileni nga 0.5 -1 kg dhe ne etiken te jepet pesha neto, vellimi i produktit, data e prodhimit, data e skadences.

## 6- FIDHE

### TREGUESIT ORGANO-LEPTIKE

- 1.Forma : Makarona fidhe per supe me forma te ndryshme..
- 2.Pamja e jashtme: Ne forme te rregullt , te plota, me siperfaqe te lemuar deri lehtesisht te ashper . Pas zierjes fidhet , te mos qulloren , te mos cahen dhe te mos krijojne shkume.
- 3.Ngjyra: E bardhe me nuance te verdhe , ne thyerje qelqore me jo me pak se gjysma e siperfaqes se seksionit.
- 4.Era dhe shija : E mire karakteristike e makaronave pa shije te hidhur , te tharte , te mykur dhe pa cfaredo ere dhe shije tjeter te huaj.

7- **Niseshteja** te jete e cilesise se pare me pako 1 kg ose me tahase 25 kg.

## 8- Oriz:

- Permbajtja te jete me kokrra te shendosha, te pastra, pa shije dhe ere myku
- Ngjyra e bardhe
- Lageshtira 12.8 %
- Aciditeti 0.081 %
- Te mos permbaje demtues apo insekte.
- Te jete i ambalazhuar ne qese polietileni 1 kg dhe ne etiken te jepet pesha neto, vellimi i produktit, data e prodhimit, data e skadences.

9- **Soda e bukes** te jete te paketuar ne pako 5 gr.

## 10- Djath i bardhe lope:



- 
- Te jete i stazhionuar, te mos jete i falsifikuar me niseshte dhe lende te huaja.
  - Te jete ngjyre i bardhe me shije te kendshme.
  - Perbajtja e yndyres te jete jo me pak se 50 %.
  - Permbajtja e kripes nga 4 + -1 %.
  - Ambalazhimi brenda kushteve higjeno-sanitare, dhe ne etikete te permbaje peshen neto, daten e prodhimit, daten e skadences.
  - Transportimi i djathrave të bute nga nje rreth ne tjetrin behet me mjete frigoriferike

## **11- Gjalpi:.**

Te jete i paketuar 0.1 – 0.5 kg

Te jete i stazhionuar.

Te mos permbaje aciditet.

Te kete densitet normal.

Te jete i cilesisese pare i frsket duke percaktuar parametrat perkates.

Te kete permbajtje kripe normale.

Te jete i shoqeruar me certificate veterinare dhe analiza fiziko kimike e mikrobike nga Drejtoria e Bujqesise e Ushqimit.

## **12- Vezët:**

- Të jene te fresketa, te inkubuara nga zogjtë e fermës (pulat) dhe që janë të përshtatshme për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor.
- Pamja e jashtme e vezes te jete e paster dhe pa plasje.
- E bardha e vezes te jete e dendur, e kulluar dhe e paster.
- E verdha e vezes, te jete kompakte dhe e plote.
- Te jene te ambalazuara ne kuti kartoni me kapacitet 30 veze secila.

## **13- VEGETË**

Erëzat e përziëra, ose vegeta siç e njohim më së shumti Të jëte cilesi ekstra, ne trajte pluhuri,pa konservues. Që përmbajtja te jete e shëndetshme, duhet që erëzat janë të freskëta dhe që te mos kene kimikate.

---

P-erberesit: Kjo mund të jetë një përzierje me hudhër pluhur, borzilok, rigon, kanellë dhe piper të zi, në kombinim me majdanoz, kopër, borzilok, rozmarinë dhe trumzë. Piperi i kuq, nenexhiku, arrëmyshk dhe qepë pluhur mund të përfshihen gjithashtu. Shumica e recetave për erëzat përfshijnë edhe kripë. Mielli i misrit është gjithashtu një përbërës që shtohet në përzierje, e cila funksionon shumë mirë me mishin e viçit, mishin e derrit, mishin e pulës ose peshkun. Është gjithashtu një shtesë e mirë për salcat e kuqe dhe salcat e bardha.

Përzierja me erëza mund të ruhet në një enë hermetike në një vend të freskët, të thatë deri në gjashtë muaj.

Ambalazhimi hermetik me qese plastike me etikete. E vetmja garanci është data e skadencës.

Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm. Raport Analiza duhet të paraqitet në original.

#### **14- Karrota:**

- Kërkohet e cilësisë së parë të padeforuara dhe me ngjyrën karakteristike të kultivarit. Gjatësia jo më pak se 10 cm, nuk lejohen kalbëzime, ndryshk nuk duhet të ketë njolla me ngjyrë jeshile pasi janë shkaktare të aciditetit dhe sëmundjeve.
- Të thata dhe të zverdhura nuk lejohen.
- Treguesit cilësorë sipas STASH 1712-88

#### **15- Patate:**

- Kërkohet cilësia e parë, të jetë e plotë, të forta, të pastra e të thata, jo jeshile, jo të mbira me ngjyrë dhe me sytha tipike të kultivarit.
- Kokrra të jetë e pjekur.
- Madhësia e kokrrës për të rrumbullaktat të jetë për pataten dimërore mbi 5 cm dhe për ato verore mbi 4 cm, për vezaket për dimëroret dhe veroret 4 cm.
- Nuk lejohen të çara e të prera, të kalbura, njolla boje hiri e ndryshku, dëmtime dhe të papastruara nga dherat.
- Treguesit cilësorë sipas STASH 1729-88.

#### **16- Reçel:**

- Te kete shije te pelqyeshme, te embel.
- Te mos kete shenja fermentimi dhe myku.
- Lageshtira jo me shume se 0.16 %.
- Hiri jo me shume se 0.07 %.

Te jete i ambalazhuar ne kavanoza qelqi dhe ne etiken te jepet pesha neto, vellimi i produktit, data e prodhimit, data e skadences

#### **17- Kripa:**

- 
- Te jete ngjyre e bardhë dhe e fortë në trajtë kokrrizash të vogla të kristalta, e tretshme në ujë, me shije të njelmët. (STASH 1437)
  - Nuk duhet te permbaje lende te huaja
  - E paketuar me etikete ku te shenohen pesha neto, vellimi i produktit, data e prodhimit, data e skadences

#### **Treguesit fiziko kimikë:**

- Imtesia ne mm 0.2 – 2
- Klorur Na ne lenden e thate ne %, jo me pak se 98.
- Klorur Mg ne lenden e thate ne %, jo me shume se 0.3
- Sulfat Mg ne lenden e thate ne %, jo me shume se 0.9
- Sulfat Ca ne lenden e thate ne %, jo me shume se 0.2
- Lende të patretshme ne lenden e thate ne %, jo me shume se 0.3
- Lageshtire ne %, jo me shume se 1
- Jodur kaliumi mg/kg 50 + - 3
- Kripa të plotesoje të gjithë kerkesat higjeno shendetsore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shendetsise.

**18- Salca** e domates te jete e cilesise se patee trashe me kuti metalike ose kanaçe 400 gr.

#### **19- Leng Limoni:**

- LENGU I Limonit përdoren edhe si bazë për gatime të shumta në kuzhinë
- Te plotesoj te gjithë treguesit cilesor

#### **20- Molla:**

- Kërkohet cilësia e parë, me formë,ngjyrë e shije të kultivarit, pa deformime, me pjekuri teknike të njëjtë, të shëndosha, të pastra, të zhvilluara normalisht, pa erë e shije të huaja.
- Lejohen edhe kokrra pa bisht, por nuk duhet te kene defekte rreth bishtit, apo dëmtime të ndryshme mekanike.
- Nuk lejohen të kimbura.
- Njolla të shkaktuara nga dielli në lëkurë nuk lejohen.
- Gunga në lëkurë nuk lejohen. Njolla nga solucionet kimike në sipërfaqen e kokrrës nuk lejohen më tepër se deri në ¼ e sipërfaqes së frutit.
- Treguesit cilësorë sipas STASH 1752\88

#### **21- Miell**

- 
- Lloji: miell gruri me rreze 80 %
  - Ngjyra: e bardhë me nuance të lehtë në të verdhë në varësi të llojit të grurit.
  - Pjesëzat e himeve janë të padukshme me rreze 80 %.
  - Era dhe shija: erë karakteristike e miellit të grurit, pa erë myku, pa shije të hidhur, të thartë dhe pa erë e shije të huaj.
  - Treguesit cilësorë sipas STASH 1455/ 87

## **22- Fasule:**

- Kërkohej cilësi e parë, të jete të fresketa, të jete e ambalazhuar dhe të mos përmbajë demtues apo insekte.
- Ambalazhimi brenda kushteve higjieno-sanitare, dhe në etikete të përmbajë peshën neto, datën e prodhimit, datën e skadencës.
- Duhet të jenë të ambalazuara në thasë 25 deri në 30 kg.

## **23- Vaj ulliri:**

- Ka veti të dobishme për shëndetin, pasi përmban vitaminë A, vitaminë E
- Nuk duhet të përmbajë lende të huaja
- Të jete i rafinuar dhe të plotesoje kërkesat teknike sipas STASH 102- 87
- Të jete i ambalazhuar, me etikete ku të shenohen pesha neto, vëllimi i produktit, data e prodhimit, data e skadencës

## **24- Maja Buke**

Të jete gati pluhur me ngjyrë të bardhë në tkafë të hapur, me erë karakteristike të majesë së bukes. Të mos ketë lageshtirë dhe erë të huaja.

Ambalazhimi: me pako në qese celofoni. Mbi ambalazh vendoset etiketaku shenohen të dhënat e mëposhtme:

Marketimi: Emërtimi i prodhuesit. Emërtimi i produktit. Pësha neto

Data e skadimit

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

**Ambalazhimi:** Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

□ Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

□ Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.

---

### **25-Qepe:**

- Kërkohe cilësia e parë,të jetë me pjekuri të plotë, me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota, me ngjyrë e forme tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 7 cm.
- Madhësia e kokrrës për ovalet të jetë nga 4 deri ne 5 cm.
- Lejohen jo më shumë se 1 % e partisë me dëmtime të lehta dhe 1 % lëndë të huaja.
- Me sëmundje nuk lejohen.

Të ngrira, te kalbura e të mykura nuk lejohen

### **26- Domate:**

- Kërkohe domate e cilësise së parë, ku të jenë të freskëta, me formë tipike të kultivarit, të plota, të pastra, të pa vrara, të pa shtypura, pa kalbje dhe pa njolla nga diegia e diellit, të pa prekura nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe të pa lagura.
- Pjekuria duhet të jetë normale, me ngjyrë të kuqe, lehtësisht rozë dhe jeshile rreth bishtit.
- Nuk lejohen domate të tejpekura, të zbutura e të vyshkura.
- Të plasura e të vrara lehtësisht për llojet e mesme e të vona lejohet deri ne 5 % plasaritje rreth bishtit, por pa rrjedhje lëngu.
- Madhësia e kokrrës të jetë jo më pak se për të hershmet 5 cm dhe për të mesmet e të vonat 7 cm
- Treguesit cilësorë sipas STASH I726-88

### **27- Speci:**

- Kërkohe cilësia e parë, të jenë me formë e ngjyrë të kultivarit, të freskëta, të pastra dhe me pjekuri natyrale.
- Lejohen dëmtime jo më shumë se 3 %.
- Shija të jetë karakteristike e kultivarit. Lejohet shije djegëse e lehtë. Nuk lejohet perzierja e specave djegës me ato jo djegës.
- Gjatësia të jetë për të gjatat mbi 10 cm dhe për të rrumbullaktat mbi 7 cm.
- Treguesit cilësorë sipas STASH I756\88

### **28- MANDARINA**

**Lloji: Mandarina per treg cilesia e pare.**

**Kërkesat cilësore :**

---

**Pamja e jashtme:** të fresket, me zhvillim normal ,të shendoshe dhe me bisht .

Para dhe pas 15 Janarit lejohen kokrra pa bisht perkatesisht 5 dhe 20 % .Me pjekuri teknike të plote. Ngjyra,shija dhe aroma . Ngjyre karakteristike e kultivarit e verdhe ne portokalli me ere karakteristike dhe shije të embel ne të athet, pa shije të hidhur.

Demttime mekanike nuk lejohen. Të prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen. Të kalbura, të mykura dhe të fermentuara nuk lejohen. Lende të huaja nuk lejohen.

Gervishtje ne siperfaqe por pa prekur tulin nuk lejohen.

Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagie të siperfaqes se tyre nuk lejohen. Të prekura nga oleooza lejohen 2 – 3 njolla per kokerr.

Permbajtja e pesdiciteteve të jete sipas normave të miratuara nga Ministria e Shendetesise. Ambalazhimi dhe etiketimi:

Frutat ambalazhohen të ndara sipas kultivareve ne arka të prodhuara sipas standarteve dhe kushteve teknike ne fuqi per cdo lloj fruti dhe të pastra.

Frutat mund të ambalazhohen edhe ne qeska plasmasi ushqimore, ose rrjeta ushqimore të lidhura, te qepura ose të ngjitura ne gryke të cilat të mbushura me fruta, vendosen ne arka ne menyre të tille, të cilat të ruhet freskia dhe konsistenca e frutave.

- Mbi cdo ambalazh vendoset etiketa ku shenohet:
- Firma prodhuese.
- Lloji i prodhimit.
- Cilesia.
- Masa neto e bruto.

Transporti i frutave të freskta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktore te tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.

## **29- Banane**

- Pamja e jashtme: të freskëta, me zhvillim normal, të pastra , me pjekuri teknike të plotë .
- Ngjyra dhe shija: ngjyra të jetë jeshile në të verdhë, me erë të këndshme, karakteristike e këtij kultivari.
- Te plotesoj te gjithë treguesit cilesor

## **30- Pjeshkë**

---

Kerkohe cilësia e parë, kokrra të jete të freskëta, me zhvillim normal, me ngjyrë karakteristike të kultivarit, të pastërta, pa bishta, me shije të embël dhe ere karakteristike të kultivarit. - Të jete me pjekuri të plotë teknike,. - Madhësia e kokrrës të jete për të hershmet deri në 50 mm, gjysëm të hershme deri në 55 mm dhe të vonshme deri në 60 mm. - Dëmtime të lehta mekanike nuk lejohen. - Dëmtime nga semundjet, insektet, dielli, ndryshim ngjyre të jete jo më shumë se 5 %. - Të mykura, të fermentuara, të kalbura dhe lende të huaja nuk lejohen.

### **31- Brokoli:**

- Brokoli është një burim i shkëlqyer i vitaminave dhe mineraleve, pasi përmban vitaminat C, K, A
- Të plotësoj të gjithë treguesit cilësor.

### **32- Lulelakër:**

- Lulelakra ka veti anti-inflamatore dhe ndikon në sistemin kardiovaskular, përmban vitaminën "K" dhe acidin omega-3. Ndësa përmbajtja e lartë në fibra e lulelakrës bën mirë për sistemin e tretjes.
- Të plotësoj të gjithë treguesit cilësor.

### **33- Spinaq:**

- Kërkohe cilësi e parë, të freskëta, të njomë, të pastër me ngjyrë jeshile të errët, të pa veshkur dhe të larë me ujë të pastër, të lidhur në dendje të vogla deri në një kg.
- Me rrenjë të prera.
- Të mos ketë prani të barërave të tjera.
- Gjethet të jenë pa njolla të ngjyrës së ndryshkut, pa dëmtime nga krimbat, pa dëmtime mekanike, të freskëta dhe të pavyshkuara.

### **34- Bizele:**

- Kërkohe cilësi e parë, të jete të ambalazuara dhe të mos përmbajë dëmtues apo insekte.
- Të plotësoj të gjithë treguesit cilësor sipas STASH 1713-88.13

### **35- Majdanos:**

- Majdanosi përmban vitaminë +C dhe K
- Të plotësoj të gjithë treguesit cilësor

---

## 36- Thjerëza

### TREGUESIT ORGANO-LEPTIKE

1.Pamja e jashtme : Kokrra te plota,me forme dhe madhesi sipas llojit (e rumbullaket-e shtypur) .

2.Ngjyra : Jeshile ne kafe .

3.Era dhe shija: Pa ere myku dhe cfaredo ere tjeter te huaj. Pas zierjes te kete ere te kendshme, pa shije te hidhur ose cfaredo ere tjeter te huaj.

### TREGUESIT FIZIKO KIMIKE

1.Lageshtia 11.2%

2.Lende te huaja jo me shume se 0.8% .

3.Kokrra te thyera jo me shume se 13% .

4.Perzierje kokrrash jo me shume se 2.2% .

5.Demtime mekanike nuk lejohen.

6.Infeksione ose demtime nga insektet nuk lejohen.

## 37- Tershera:

- Tërshëra është një ushqim mjaft i lehtë për fëmijet dhe me vlera të mëdha ushqimore në të njëjtën kohë.
- Te jete brenda afatit te skadences.

## 38- Trahana:

- Trahanaja është një ushqim i lashtë, i përftuar nga fermentimi i drithrave – kryesisht grurit, i cili e bën atë me të shijshëm dhe rezistent në kohë.
- Te jete e pasur ne minerale, acide organike, proteina dhe fibra
- Te jete brenda afatit te skadences

**39- Çokokrem** te jete cilesi ekstra, mase homogjene ne trajte kremi me kakao, lajthi , qershi dhe qumesht pluhur, pa konservues.



---

Perberesit:

Qumesht pluhur, sheqer, yndyra 26%, Kakao, Lajthi 10-12%.

Ambalazhimi hermetic me vazo plastike me peshe 1 Kg me etikete.

#### 40- Mish pule:

- Mish pule, cilesia e pare.
- Transporti i mishit do te behet me mjete të mbyllura, të pastra e të dezinfektuara, posaçerisht per mishin dhe te pajisura me frigorifer.

#### 41- Kanella:

- Kanella është një erzë e cila përdoret në shumë ushqime
- Te jete i ambalazhuar, me etikete ku te shenohen pesha neto, vellimi i produktit, data e prodhimit, data e skadences

#### 42- Vaj Vegjetal:

- Pamja e jashtme te jete e kthjellat dhe pa turbullire. (STASH 2121- 87)
- Ngjyra te jete e verdhe.
- Nuk duhet te permbaje lende te huaja.
- Te jete i rafinuar dhe aciditeti te mos kaloje 0.4 %.
- Te jete i ambalazhuar ne shishe plastike 1 litershe, transparente me etikete ku te shenohen pesha neto, vellimi i produktit, data e prodhimit, data e skadences.

#### 43- Gjize:

- Gjiza është një nën produkt i qumështit. Lloj bulmeti në trajtën e dromcave të buta e pak të ujshme, që përgatitet nga qumështi, kosi, dhalli.
- Ambalazhimi brenda kushteve higjieno-sanitare, ne ene plastike ose material qelqi.

#### 44- Lakër e bardhe

Kerkohet cilesi e pare, te fresketa , me zhvillim normal, me pjekuri teknike te plote :

- Ngjyra te jete e bardhë, me ere dhe arome te kendeshme karekteristike e ketij kultivari.
- Madhesia e kokrres te jete mesatare.
- Demtime mekanike nuk lejohen.
- Njolla te verdha-kafeta qe tregojne tejkalinimin e pjekurise nuk lejohen.
- Gervishtje te lekures nuk lejohen.
- Zbutje te lekures nuk lejohen.

- 
- Malli te jete i shoqeruar me etiketen e cilesise .

#### **45- Laker e kuqe**

**Kerkohet cilesi e pare, te fresketa , me zhvillim normal , ne tufe , me pjekuri teknike te plote :**

Ngjyra te jete e kuqe, me ere dhe arome te kendeshme karekteristike e ketij kultivari.

Madhesia e kokrres te jete mesatare.

Dentime mekanike nuk lejohen.

Njolla te verdha-kafeta qe tregojne tejkalinimin e pjekurise nuk lejohen.

Gervishtje te lekures nuk lejohen.

Zbutje te lekures nuk lejohen.

Malli te jete i shoqeruar me etiketen e cilesise .

#### **46- Miell Orizi**

Ngjyra: E bardhe me nuance ngjyre te verdhe Era dhe shija: Karakteristike e miellit te orizit, pa shije te tharet e te hidhur, pa ere te mykur dhe ere tjeter te huaj. Treguesit fiziko- kimike:

Lageshtia: 12.8% Aciditeti 0.081% Lende te huaja jo me shume se 0.2% Lende minerale nuk lejohen. Ambalazhimi i paketuar ne qese letre me peshe 0.5kg.-1kg. Marketimi: Emertimi i prodhuesit Emertimi i produktit. Pesha neto Data e skadimit Kushtet e vecanta te ruajtjes Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit. Raport analiza e paraqitur duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

#### **47- Kungull:**

- Kungulli është një perim me super veti ushqyese, i pasur me vitamina dhe minerale
- Te plotesoj te gjithe treguesit cilesor

#### **- Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të kontrates në lidhje me materialet:**

- Te gjithe artikujt qe do te furnizohen duhet te jene te ambalazuara.
- Trasporti i produkteve ushqimore do te sigurohet nga vete furnizuesi deri ne magazinën e institucionit te Bashkise Pogradec.
- Ambalazhimi duhet te kete datën e prodhimit dhe te skadences te mallit.
- Ne rast se malli objekt prokurimi, nuk ploteson kerkesat dhe standartet teknike lidhur me sasine, cilesine dhe elementet e tjere, nuk do te merret ne dorezim.

- 
- Transporti i perimeve të fresketa do të behet me mjete të pastra, të mbrojtura nga demtimet e faktoret e tjere atmosferik, duke zbatuar rregullat higjeno – sanitare per transportimin e produkteve ushqimore.
  - Produktet ushqimore, objekt i VKM Nr.1344,date 10.10.2008 “Per miratimin e rregullave per etiketimin e produkteve ushqimore” duhet te jete te pajisura me etiketat respektive
  - Transporti i produkteve ushqimore, duhet te behet me mjete dhe pajisje te posacme te llojeve dhe madhesive te ndryshme ne funksion te sasise qe ofrohet si dhe per te ruajtur cilesine e ushqimit.
  - Subjekti mer persiper transportin e produkteve ushqimore ne magazinën e Bashkise dhe nga magazina ben shperndarjen ne institucionet e arsimit parashkollor (kopshte & cerdhe)
  - Per detaje me te veçanta do te percaktohen ne kontraten objekt prokurimi me operatorin ekonomik te shpallur fitues.

**Do te jete operatori ekonomik i shpallur fitues ai i cili do te beje furnizimin me mallra sipas kerkeses se QAB, ne magazinën e QAB.**

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Preventiv ushqimesh kopesht dhe çerdhe per vitin 2021

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Bukë	kg	2700		
2	Qumësht	liter	6000		
3	Mish viçi	kg	925		
4	Sheqer	kg	605		
5	Makarona	kg	720		
6	Fidhe	kg	210		
7	Nisheste	kg	50		
8	Oriz	kg	710		
9	Sodë buke	pako	200		
10	Djathë i bardhë	kg	360		
11	Gjalpë	kg	341		
12	Vezë	kokërr	16300		
13	Vegetë	kg	45		

---

14	Karrota	kg	540		
15	Patate	kg	3830		
16	Reçel	kg	190		
17	Kripë	kg	210		
18	Salcë domate	kg	170		
19	Lëng limoni	copë	200		
20	Mollë	kg	2000		
21	Miell	kg	580		
22	Fasule	kg	320		
23	Vaj ulliri	Litër	308		
24	Maja buke	copë	60		
25	Qepë	kg	360		
26	Domate	kg	410		
27	Speca	kg	380		
28	Mandarina	kg	1100		
29	Banane	kg	1780		
30	Pjeshke	kg	250		
31	Brokoli	kg	193		
32	Lulelaker	kg	125		
33	Spinaq	kg	197		
34	Bizele	kg	280		
35	Majdanoz	tufa	150		
36	Thjerrëza	kg	175		
37	Tërshërë	kg	270		
38	Trahana	kg	240		

---

39	Çokokrem	kg	60		
40	Mish pule	kg	403		
41	Kanellë	pako	120		
42	Vaj vegjetal	litra	335		
43	Gjizë	kg	240		
44	Lakër bardhe	kg	250		
45	Lakër kuqe	kg	200		
46	Miell orizi	kg	50		
47	Kungull	kg	130		
	TOTALI				

Shuma

TVSH 20%

TOTALI

**Afatet e lëvrimt:**

**12 muaj**

Sasia e mallit që kërkohet:

## **SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

Afatet e lëvrimt:

Furnizimi me artikuj ushqimore do filloje me daten e nenshkrimit te kontrates nga Autoriteti Kontraktor me Kontraktuesin e deri me konsumimin e plote te kontrates per cdo artikull.

1. Artikujt ushqimore dorezohen ne magazinat e institucioneve brenda orarit zyrtare te kohes se punes, nga perfaqsesi ligjore ose personi i autorizuar prej tij.

- 
2. Furnizimi e marrja ne dorezim te artikujve ushqimore behet ne magazinat e perdoruesit ne prani te paleve.
  3. Furnizimi mujore do te behet brenda limiteve te kontrates, sipas grafikeve dhe kerkesave te perdoruesve.
  4. Furnizimi ne artikujt, fruta, bulmeti dhe mishi do behet ditore.

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

---

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.



---

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari ofertes sipas shtojcës 1*

d. *Listat e çmimeve të artikujve sipas shtojcës 2*

e. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

*(Pika e do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (Shtojca 7).

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet 2019,2020 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet”. Në plotesimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë: Vërtetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpërmendura.*

**2.2.2** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

---

(Pika 2.2.2 e kapacitetit ekonomik dhe financiar do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet te paraqese perpara nenshkrimt te kontrates dokumentin e deklaruar si më lart).

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

Ofertuesi duhet të dorezojë:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

- Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) a- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore/ente publike, operatorët ekonomik duhet të paraqesin vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e furnizimeve ose faturën/faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatorët ekonomik duhet të paraqesin faturën/faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje:

- License kategoria: **II.1.A. 1 “Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”**, te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit.

**2.3.3** Operatori Ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikaten perkatese te vlefshme, si me poshte:

- Çertifikaten e Menaxhimit te Cilesise (ISO) **9001:2015, e vlefshme**, per cilesine e mallrave/produkteve ushqimore, ose ekuivalente.

---

**Shënim:** Certifikata ISO duhet të jetë lëshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Në rastet e bashkimit** të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikaten, ISO në përputhje me % e bashkëpunimit.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të paraqesë vetedeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU-se, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

**2.3.5** Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose në përdorim, një automjet të përshtatshëm ATP për të bërë transportimin e mallrave pranë kopeshtit dhe Cerdhës, në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, të vertetuar me dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor, leje qarkullimi, policen e sigurimit, certifikata e kontrollit teknik si dhe certifikate pronësie të mjetit.

Në rast se mjete të tilla janë marrë me qira të shoqërohet me kontrata qeraje notoriale.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 8.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I, Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I:**

**Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigjja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

<b>Emri i nënkontraktorit të propozuar</b>	<b>NIPT -i</b>	<b>Përqindja e nënkontraktimit</b>	<b>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</b>

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

### **A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
